

## 🔊 NJOFTIM PËR SHPALLJE VAKANCASH PRANË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

Në kuadër të bashkëpunimit institucional me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve me qëllim rritjen e informimit public dhe inkurajimit të të gjithë qytetarëve që plotësojnë kriteret ligjore të aplikojnë dhe të përfitojnë nga mundësitë e punësimit në shërbim të sigurisë dhe rendit publik, Bashkia Durrës informon dhe sensibilizon punëkërkesit për sa më poshtë vijon:

🚦 200 (dyqind) punonjës të Policisë së Burgjeve – roli bazë për Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në nivel kombëtar.

🚦 Çfarë ofrohet?

- Pozicion pune i garantuar;
- Trajnim profesional për të gjithë punonjësit e rinj;
- Uniforma e punës sigurohet nga institucioni;
- Transport falas drejt disa IEVP-ve kryesore;
- Sigurim jete dhe shëndeti për 3 (tre) vite;
- Mundësi reale për ecuri në karrierë;
- Pagë fillestare: 62,500 Lekë.

### 🏢 Afati i aplikimit

Dorëzimi i dokumentacionit për kandidatët është deri më datë **03.03.2026**, sipas kriterëve të përcaktuara në njoftimin zyrtar të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

🔗 Për informacion të detajuar mbi kriteret dhe procedurën e aplikimit, vizitoni:  
<https://dpbsh.gov.al/>, rubrika “Njoftime punësimi”